

<i>Emri i Fondit</i>	Fondi i Pensionit Vullnetar <b>SIGAL</b>
<i>Struktura Ligjore</i>	Fond Pensioni* Licencuar nga AMF me licencë nr. 2, datë 30.03.2011
<i>Administrimi i Fondit</i>	Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" Sh.a.
<i>Themeluar</i>	Janar 2006
<i>Monedha</i>	Lekë
<i>Banka Depozitare</i>	Banka Amerikane e Investimeve Sh.a.
<i>Auditues</i>	Pricewaterhousecoopers Assurance Services Sh.p.k.

\*Rregulluar nga Ligji nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar"

<i>Komision në Hyrje</i>	0%
<i>Komision në Dalje</i>	0%
<i>Komision Vjetor Administrimi</i>	2.20%
<i>Penalitet për tërheqje të parakohshme</i>	Sipas Rregullores së AMF
<i>Komision Performance</i>	0%
<i>Shuma fillestare e kuotës</i>	1.000 Lekë
<i>Kontributi fillestar minimal</i>	1.000 Lekë
<i>Kontributi minimal pasues</i>	1.000 Lekë

### Objektivat dhe Politika e Investimit

#### Objektivat e Investimit

Fondi i Pensionit ka për qëllim të maksimizojë kthimin afatgjatë të investimit nëpërmjet administrimit të kujdesshëm dhe konservator të rrezikut të investimit.

#### Politika e Investimit

Asetet e Fondit do të investohen me synim për të rritur kthimin nga investimi për anëtarët e tij dhe për t'ju siguruar atyre një të ardhme të sigurt.

Instrumentat në përbërjen e portofolit janë: (i) tituj të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, me maturitete të ndryshme, (ii) mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe (iii) Depozita me afat në banka të nivelit të dytë të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

### Të dhënat kryesore për Fondin në 31 MAJ 2023

<i>Vlera Neto e Aseteve</i>	2,641,868,033 Lekë
<i>Numri i anëtarëve</i>	10,908
<i>Çmimi i Kuotës</i>	1,619.8837 Lekë
<i>*Fitimi vjetor (31/05/22-31/05/23)</i>	3.38%
<i>**Kohëzgjatja</i>	4.42

\*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

\*\*Kohëzgjatja në datën e raportimit 31.05.2023

\*\*\* Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen

## Portofoli i Investimeve në datën 31 Maj 2023

### Përbërja e portofolit




Figura 1-Përbërja e portofolit sipas kategorive

### Përbërja e portofolit





Figura 2-Përbërja e portofolit sipas maturitetit të mbetur

## Profili i Rrezikut dhe Përfitimit



Profili i Rrezikut dhe Përfitimit të Fondit tregon luhatshmërinë historike të çmimit të kuotës.

**Për Fondin e Pensionit Vullnetar SIGAL, treguesi është në nivelin 1, ose nivel më i ulët i rrezikut.**

Fondi ndodhet në këtë kategori pasi portofoli i investimeve është në pjesën kryesore të tij në Tituj të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

Treguesi është i bazuar në të dhënat historike të 5 viteve të fundit dhe kategoria e rrezikut mund të ndryshojë në të ardhmen.

## Performanca e Fondit

Performanca e Fondit deri në 31.05.2023

Gjatë muajit Maj 2023 çmimi i kuotës dhe Vlera Neto e Aseteve të Fondit kanë patur një trend rritës. Norma e rritjes të çmimit të kuotës për këtë muaj ka rezultuar 0.30%.

Fitimi vjetor neto (%) për 12 muajt e fundit (Periudha: 31/05/22-31/05/23) ka shënuar nivelin 3.38%. Fitimi neto i pesë muajve të parë 2023 ka rezultuar në nivelin 1.40%.



Rekomandohet që anëtarët të qëndrojnë sa më gjatë në fond në mënyrë që të përfitojnë maksimalisht nga kthimi i investimit.

### Performanca vjetore (%)

	2018	2019	2020	2021	2022
Fondi	<b>4.30</b>	<b>4.17</b>	<b>3.53</b>	<b>3.67</b>	<b>3.63</b>


### Rritja e Vlerës Neto të Aseteve (%)

	2019-2020	2020-2021	2021- 2022
Fondi	<b>19.45</b>	<b>28.37</b>	<b>21.68</b>



\*\*\* Të dhënat e mësipërme janë të ndryshueshme në varësi të kusheve të tregut dhe nuk përbëjnë garanci për të ardhmen.

## Ecuria e Tregut të Titujve të Qeverisë Shqiptare



Tregu i Titujve të Qeverisë Shqiptare është karakterizuar nga një rritje e konsiderueshme e rendimentit për titujt për të cilët janë organizuar ankande gjatë këtij muaji. Raporti mesatar i mbulimit në ankandet e këtij muaji ka rezultuar 1.55, një rënie nga 1.74 raport mbulimi gjatë muajit prill 2023.

Obligacioni 2 vjeçar ka rezultuar me rendiment 4.35% nga 4.35% me një rënie prej 0.19% krahasuar me ankandin paraardhës.

Për obligacionin 3 vjeçar rendimenti ka shënuar nivelin 4.54% nga 4.57% me një rënie prej 0.03% krahasuar me ankandin paraardhës.

Obligacioni 5 vjeçar ka rezultuar me rendiment 4.77% nga 4.89% me një rënie prej 0.12% krahasuar me ankandin paraardhës.

Për obligacionin 7 vjeçar rendimenti ka shënuar nivelin 5.21% nga 5.45% krahasuar me ankandin e muajit Mars 2023, pasi në muajin prill 2023 nuk janë zhvilluar ankande për obligacione me afat 7 vjeçar.

Për obligacionin 15 vjeçar rendimenti ka shënuar nivelin 7.08% nga 6.80% me një rritje prej 0.28% krahasuar me ankandin e muajit shkurt 2023, pasi në muajt mars dhe prill 2023 nuk janë zhvilluar ankande për obligacione me afat 15 vjeçar.

Për obligacionet me afat 10 vjeçar nuk është zhvilluar ankand në muajin Maj 2023, ndaj i referohemi interesave të fundit, respektivisht 6.60% obligacioni 10 vjeçar në muajin prill 2023.

### Informacion Praktik

#### Trajtimi Fiskal

Fondi është një grup asetesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, për rrjedhojë nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat, ose taksës mbi vlerën e shtuar. Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga anëtarët bazohet në nenet 88, 89 dhe 90 të ligjit nr.10 197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar". Lidhur me detajet referojuni seksionit "Tatimi" të Prospektit të Fondit.

#### Deklaratë

Ky dokument ofron informacione kryesore për anëtarët në lidhje me Fondin e Pensionit Vullnetar SIGAL. Anëtarët këshillohen dhe janë të ftuar të lexojnë Prospektin e Fondit në mënyrë që të marrin një vendim të mirë informuar. Informacioni i përditësuar mbi çmimin e kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Fondit të Pensionit Vullnetar SIGAL dhe në <https://fondisigal.com.al/>

#### Kontakt:

Rr. "Ukraina e Lirë", Tiranë

Email: [info@fondisigal.com.al](mailto:info@fondisigal.com.al)

Tel: +355 (0) 44 511 666